



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-30356/24, më 28-02-2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58, shkronja f) dhe të nenit 62, paragrafi 62.2 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 Qershor 2008), nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, nenit 52, shkronja f), nenit 56, paragrafi 56.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e drejtores të Drejtorisë së Kulturës

1. Znj. Sibel Halimi, emërohet në pozitën e drejtores të Drejtorisë së Kulturës të Kryeqytetit, nga data 20 Shkurt 2024.
2. E emëruara do të udhëheqë dhe menaxhojë Drejtorinë në përputhje me udhëzimet e Kryetarit të Kryeqytetit, ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.
3. E emëruara do t'i raportoj rregullisht Kryetarit të Kryeqytetit për procesin e vendimmarrjes dhe funksionimin e Drejtorisë që udhëheq.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Znj. Sibel Halimi;
- Zyrtarit për paga;
- Sektorit për burime njerëzore;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

